



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
GJUHË C (1)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 0 leksione / 40 seminare
Viti / Semestri: Viti I ,semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor pranë Departamenteve të tjera FGJH
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Lënda **Gjuhë C (1)** i drejtohet studentëve të vitit të parë bachelor (FGJH, UT), të cilët e zgjedhin atë si gjuhë të dytë. Lënda i shërben mësimi të gjuhës së huaj në nivel të fillestar gjuhësor. Ajo i shërben gjithashtu praktikës sociolinguistike të koncepteve bazë morfo-sintaksore. Kjo është një lëndë me karakter formues si në njohjen e një gjuhe ashtu dhe në njohjen e kulturës së saj. Ushtrimet janë strukturuar në mënyrë të tillë që të verifikohet përvetësimi i tyre si në aspektin ngushtë gjuhësor ashtu edhe në atë kulturor.

Objektivat specifike lëndore:

Studenti duhet të jetë i aftë të:

1. Të prezantojë veten duke përdorur fjali të shkurtra dhe të thjeshta. Të tregojë shkurtimisht diçka për veten (p.sh. emrin) apo të pyesë dikë se ku banon apo çfarë pune kryen.
2. Të përdorë fjali që shprehim pohim apo mohim.
3. Të përdorë shprehi të mirësjelljes dhe të përshëndetjes formale dhe joformale.
4. Të komunikojë me fjali të shkurtra dhe të thjeshta profesionet e ndryshme apo vendndodhjen e punës apo të banimit.
5. Të përshkruajë në terma të thjeshtë pjesëtarët e familjes, numrin dhe karakteristikat e tyre.